



-
Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 20/15

Prishtinë, më 27.5.2015, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Safete Hadergjonaj, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti.

Munguan: Besa Gaxherri dhe Fikrim Damka.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Islami dhe Mentor Hyseni nga GIZ, Lumnije Murati nga Zyra e Presidencës, Sabina Hoti – praktikante nëm Zyrën e Presidencës, Sulejman Blaku nga Kosova Sot, Jashar Kastrati nga Institucioni i Avokatit të Popullit, Albulena Mavraj nga Epoka e re.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Integritet Evropian;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se përmban kosto buxhetore shtesë prej 80,000 euro për vitin 2016 dhe po në këto shuma edhe në vitin 2017 dhe 2018, por se kjo kosto do të mbulohet nga kursimet e brendshme të institucioneve që implementojnë ligjin. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoj se komisioni unanimitet nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, po ashtu nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoj se komisioni unanimitet nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të

Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se përmban kosto buxhetore shtesë prej 167,452 euro për vitin 2016 dhe po në këto shuma edhe në vitin 2017 dhe 2018, por se kjo kosto do të mbulohet nga kursimet e brendshme të institucioneve që implementojnë ligjin. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimitas nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, po ashtu nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimitas nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
6. **Shqyrtimi i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se përmban kosto buxhetore shtesë prej 550,000€ në vit nga 2016, por në të njëjtën kohë parashihen të realizohen të hyra nga vendimet e gjykatave prej 564,070 euro bazuar në të dhënat e vitit 2013, që do të thotë se kemi një pothuajse një barasvlerë në mes kostos dhe të hyrave që pritet të krijohen, por se kjo kosto do të mbulohet nga kursimet e brendshme të institucioneve që implementojnë ligjin. Amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-36 për kompensimin e viktimave të krimit, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se përmban kosto buxhetore shtesë. Kjo kosto ka të bëjë me kategorinë paga dhe mëditje. Mirëpo me amendamentin e propozuar nga komisioni funksional, paga e avokatit të popullit do të jetë e barasvlershme me ministrin, ndërsa paga e zëvendës avokatëve të popullit me zëvendësministrat, e që në fakt do të kemi zbritje të pagave të avokatit dhe zëvendësve të tij, nga paga që kanë aktualisht. Por, një përcaktimin i tillë i pagave zbret edhe koston buxhetore të vlerësuar në deklaratën financiare.

Safete Hadergjonaj - propozimi im është që të rregullojmë që paga e avokatit të popullit dhe zëvendës avokatëve të përcaktohet me ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publik. Deri në miratimin e këtij ligj, pagat të mbesin në nivelin që i kanë.

Pas sqarimeve dhe propozimit, Kryetari konstaton se komisioni me tetë vota Për, një Kundër (Safete Hadergjonaj) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga komision funksional, po ashtu nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimitasht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, po ashtu nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimitasht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-20 për Barazi Gjinore, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve dhe Amendamenteve të Komisionit funksional për të Integritet Evropian

Kryetari – theksoi se në bazë të deklaratës financiare të përgatitur nga ministria e financave, projektligji është vlerësuar se nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, po ashtu nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se komisioni unanimitasht nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-30 për Përgjimin e Telekomunikimeve, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Integritet Evropian, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani